



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 27.11.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për Ri-Shqyrtim të datës; 26.11.2024, të parashtruar nga OE N.T.P." Begisholli lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Ruc të Ri" me nr. të Prokurimit 613-24-9854-5-1-1., Autoriteti kontraktues nxjerr:

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim, kërkesë e paraqitur më dt; 26.11.2024, nga N.T.P." Begisholli, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Ruc të Ri" me nr. të Prokurimit 613-24-9854-5-1-1.

Vërtetohet, Njoftimi mbi Vendimin e AK-së, i publikuara në platformen e prokurimit të datës: 21.11.2024.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit ka pranuar kërkesë për Rishqyrtim më dt: 26.11.2024, për aktivitetin e prokurimit me titull "Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të R" me nr. të Prokurimit 613-24-9854-5-1-1, përmes sistemit elektronik ne E-prokurim.

Pretendimi juaj i parë:

1. **Sqarim:** Komisioni për vlersim te ofertave ka shikuar ne perpikmeri oferten tuaj dhe ka verejtur mangesi ne oferten tuaj,

Per paisjet metalike shallona betoni, ju nuk keni ofruar deshmi per keto paisje dhe te njejtat nuk i keni te paraqitura ne listen e paisjeve te prezantuar nga ana juaj

Per paisjen kompresor ajri per thyerje, poashtu per te njejten pasije nuk keni ofruar deshmi per kete paisje dhe nuk e keni te njejten te prezantuar ne listen e paisjeve te ofruar nga ana juaj

Per paisjen auto mikser betoni te ofruar me marreveshje prej 7 paisjeve te ofruara, vetem 2 prej tyre kan qene me validitet, te tjerat kan qene me validitet te skaduar, dhe ne rast qe dokumenti eshte dorezuar dhe nuk ploteson deshmite ateher oferta juaj renditet si e papergjegjshme dhe nuk ka hapsire per sqarim.

Per kamion kiper nuk eshte kerkuar sqarim pasiqe edhe po te kerkohej sqarim per kete pike prapëseprapë keni pasur pika tjera qe te cilat nuk lejohet te kerkohen infromata shtese sipas LPP-se.

Ky pretendim është i pa bazuar.

Pergjigjeja në pretendimin e dytë;

1. Sa i përket referencave OE ka përmbushur kërkesat e AK-së sipas DT. Sepse tek Kërkesa 1 eshte kerkuar qe. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlere prej 750,000.00 Euro per (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, Sqarim OE ka prezantuar deshmi te mjaftushme per projekte te ngjashme lidhur ne kete AP qe ka te beje me ndertim dhe me infrastrukture. Sqarim: Sikur te ishte ne kerkese ne NJK dhe TD per projekte te njejta do ishte i arsyeshm pretendimi juaj.


Ky pretendim është i pa bazuar.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë, më dt; 27.11.2024, ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtör i Prokurimit